

## **Fjalim i deputetes Greta Bardeli**

13.07.2023

– Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Më në fund u erdhi radha edhe zonave të Veriut, që të prekin investimet e kësaj qeverie.

Patjetër, si deputete e qarkut të Shkodrës do të votoj për këtë investim që po bëhen në dy qarqet e zonave të Veriut, në Lezhë dhe në Shkodër.

Edhe pse kam rezervat e mia në lidhje me këtë projektligj, të cilat i kemi diskutuar edhe në komisione, unë i ftoj të gjithë kolegët e mi të zonës së Veriut, që ta votojnë dhe ta mbështesin këtë investim që po bëhet në këto zonave.

Një vëmendje të veçantë, në fakt, kërkojnë investimet në infrastrukturën rrugore.

Më 6 korrik të vitit 2023, në “rrugën e vdekjes”, sikurse e kanë pagëzuar banorët e zonës (është rruga që lidh 3 njësitë administrative: Pult, Shosh dhe Shalë), u shtua viktimat e radhës. Një kumt i zi mbuloi të gjithë zonën e Dukagjinit. Një nga burrat më të mirë të asaj zone, i ndjeri Gjelosh Rushaj, humbi jetën për shkak të shembjes së asaj rruge. Unë sot, më e motivuar se kurrë, dua t’ju drejtohem juve, si kolegë deputetë, por edhe të gjithë banorëve të qarkut të Shkodrës, dukagjinase që jetojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, duke lexuar një peticion, i cili është hartuar nga banorët dhe organizatorët. Këtu vlen të theksohet fakti se një nga organizatorët e lëvizjes “Dukagjini kërkon rrugën” ishte pikërisht edhe i ndjeri Gjelosh Rushaj. Ky peticion vjen në mbështetje të 6101 firmëtarëve, të cilët më parë u janë adresuar të gjitha zyrave të pushtetit lokal dhe qendror, duke zhvilluar edhe seminare të ndryshme teknike, edhe thirrje në media, dhe këtu vlen të theksohet fakti se banorët zhvilluan edhe dy protesta shumë qytetare, në të cilat kërkonin rindërtimin dhe asfaltimin e rrugës së Dukagjinit.

Në peticion thuhet: “Dukagjini i izoluar rrezikon shumë jetë njerëzish. Rruga e Dukagjinit është një aks rrugor shumë i rëndësishëm, që lidh Shkodrën me 3 njësitë administrative: Shosh, Shalë dhe Pult. Për shkak të mungesës së investimeve dhe mungesës së vëmendjes së autoriteteve vendore dhe qendrore, kjo rrugë ka pësuar shumë dëmtime, duke sjellë pasoja të rënda, deri në humbjen e jetëve të banorëve të zonës. Rruga e Dukagjinit, e ndërtuar 55 vjet më parë, sot është krejtësisht e amortizuar, jashtë çdo parametri teknik dhe ligjor. Rrezikohet jeta e banorëve dhe e mijëra vizitorëve që e përshkojnë këtë aks rrugor në periudha të ndryshme të vitit. Janë mbi 60 persona që kanë humbur jetën në këtë aks rrugor dhe qindra të tjerë të plagosur dhe të gjymtuar, vendas dhe të huaj. Mungesa e rrugës po shkakton edhe shpopullimin e kësaj zone. Banorët janë lënë jashtë shërbimit të rregullt shëndetësor dhe arsimor, pa të drejtë pronësie dhe larg mundësive të barabarta për zhvillim ekonomik”.

Për sa më sipër, banorët dhe hartuesit e këtij peticioni u janë drejtuar Këshillit të Ministrave dhe Kryeministrit të Shqipërisë, Presidentit të Republikës dhe Kryetares së Kuvendit.

Prandaj, të nderuar kolegë, sidomos ju, qeveritarë, që jeni të pranishëm në këtë seancë, ju ftoj t'i hidhni përsëri sytë për investime të qenësishme për rrugën e Dukagjinit!

Ju faleminderit!